



## PROCESVERBAL

Mbledhja e rregullt e **Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF)**, e mbajtur më **16.7.2024**, me fillim në orën **10:15**. Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit, **Arbër Zenuni**.

**Kryesuesi:** Fillimisht, përshëndetje për të gjithë! Përshëndetje nënkryetar **Fatmir Iska**. Të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtorë të drejtorive, zyrtarë komunalë, përfaqësues të KFOR-it, të gjithë ju të pranishëm! E hapim mbledhjen e **shtatë (7)** të Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2024. Në konsultim me kryetarin e Komunës kemi përgatitur këtë rend dite:

## REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale Nr. 00889-0, ZK- Çifllak, në sipërfaqe prej 11765m<sup>2</sup>;
3. Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës P-00889-0 ZK, Çifllak, në sipërfaqe prej 11765m<sup>2</sup>;
4. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale Nr. 00889-0, ZK- Çifllak, në sipërfaqe prej 10,000 m<sup>2</sup>;
5. Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, P-00889-0ZK, Çifllak, në sipërfaqe prej 10,000 m<sup>2</sup>;
6. Shqyrtimi i propozim-vendimit për faljen e borxhit të papaguar për taksën komunale, respektivisht qiranë e shfrytëzimit të hapësirës publike;
7. Të ndryshme.

- Shtesë:** 1. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik P-00041-1, ZK-Drenoc;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik, ndërtesën P-00644-0, ZK-Rahovec.

**Kryesuesi:** Atëherë, ky është rendi i ditës për sot. Drejtori për Gjeodezi ka edhe dy pika shtesë për këtë mbledhje të KPF-së.

**Afrim Oruqi:** Faleminderit, kryesues! I nderuar nënkryetar, kolegë drejtorë, anëtarë të KPF-së. Në lidhje me një shkresë që ka arritur dje nga AKP-ja për disa lokale dhe ndërtesa në Komunën e Rahovecit dhe për këtë arsye nuk e keni materialin para vetes. Bëhet fjalë për dy vendime që do t'i shpallim me interes publik. Janë dy lokale në komunë të Rahovecit dhe një objekt-ndërtesë administrative në ZK-Drenoc, ku ka qenë shtabi i UÇK-së.

**Defrim Kafexhiu:** Përshëndetje për të gjithë! Drejtor, nëse keni mundësi për më shumë sqarime, çka saktësisht kërkon AKP-ja nga Komuna?

**Afrim Oruqi:** Ligjërisht AKP-ja obligohet që para çdo shitjeje t'i njoftojë kryetarët e komunave, duke i pyetur nëse kanë interes për ato parcela, lokale apo ndërtesa administrative, para se ata t'i shesin. Ne kemi afat 15 ditë të reagojmë me shkrim. Kushti që ta ndalim AKP-në t'i shesim është shpallja në interes publik dhe pastaj të vazhdojmë me procedura të tjera ligjore.

**Burim Krasniqi:** Meqenëse jemi para votimit të rendit të ditës, i kam dy propozime: E para, ka më shumë se dy javë që raporti auditorit është publikuar në ueb-faqe, pse nuk është në këtë seancë? Besoj që është ngarkesë nëse është në gusht, kur e kemi edhe qarkoren e dytë buxhetore, KAB-in, buxhetin. Konsideroj që është mirë ta kemi në rend dite, duke pasur parasysh që sot nuk është seanca e ngarkuar me pika të rëndësishme. E dyta: Në seancën e kaluar për informata rreth apo mbi shfrytëzuesit e parcelave publike, të dhëna për shfrytëzim mbi bazën e vendimit të asamblesë komunale. Nuk dua të jap asnjë vlerësim për punën e bërë të komisioneve, por janë prona publike të dhëna në shfrytëzim dhe konsideroj që është e rrugës që asambleistët me qenë të informuar se kush i ka marrë ato prona. Kërkoj që edhe kjo pikë të futet në rend dite.

**Afrim Limani:** Burim, e vërtetë që ka ardhur raporti i ZKA-së, ndoshta i ka 10 ditë. Historikisht i kemi mbajtur në seancën e gushtit e cila parashihet të jetë më pak e ngarkuar. Tani e kam raportin financiar dhe propozimi im ka qenë që raporti i auditorit të jetë në seancën e gushtit.

**Nënkryetari:** I nderuari kryesues, anëtarë të KPF-së, drejtorë, të pranishëm! Informatën e raportit 6-mujor financiar do ta kemi në fund të muajit, në këtë seancë. Tani e kemi veç si rekomandim, nuk e di a e ka shpërndarë Albioni. Raporti i ZKA-së do të jetë në muajin gusht, ashtu siç është paraparë me plan të punës së Kuvendit. Sa i përket dhënies në shfrytëzim, në këtë seancë që po vjen do ta kemi, gjithashtu do të diskutojmë dhe do ta japim kontributin në seancën e kuvendit komunal.

**Burim Krasniqi:** Kur po flasim, nuk dua të shihemi si opozitë “destruktive”. Raportin financiar nuk e kemi për korrik. Besoj që nuk është e njëjta gjë dhe të thoni që nuk është në KPF, sepse nuk ka nevojë për votim. Është e palogjikshme, atëherë hiqeni KPF-së. Raporti i kryetarit, financiar dhe i auditimit, janë raporte të rëndësishme që i ka komuna dhe nëse mendoni që nuk duhet të jenë në KPF, atëherë është gabim. Komiteti për Politikë dhe Financa mos ta ketë raportin financiar, atëherë pse është? Emri i komiteti është për “politikë dhe financa”. Për mua është e papranueshme. Është praktikë e keqe që po instalohet. Politika është rrotacion, mos harroni, kurrë nuk i dihet ku jemi, e si jemi. E dyta, te çështja e informatës, që është temë për parcelat në shfrytëzim, nuk besoj që e kërkoj për ta diskutuar, sepse janë komisionet që ne ia kemi besuar punën. Është mirë që të jemi në dijeni se çka po ndodh. Raportin e ZKA-së, kjo përbërje e asamblesë komunale, e ka diskutuar në korrik dhe jo në gusht.

**Skender Hamza:** Përshëndetje kryesues, nënkryetar dhe ju anëtarë të KPF-së! Burim, mund të kesh edhe të drejtë, por kur është bërë plani i punës së kuvendit kemi marrë vendim me grupin që informatat dhe raportet mos të vijnë në KPF, por të shkojnë drejt në kuvend dhe kjo ka qenë si rekomandim. Në këtë rast, te raporti financiar, mendoj që është propozim me vend.

**Burim Krasniqi:** Skend, nuk është që “mund” të kesh të drejtë, por kam të drejtë. Fjalën “mund” hiqe nga fjalori. Plan i punës së Kuvendit nuk e diskuton çështjen e KPF-së, por çështjet e punës së Kuvendit. Komiteti për Politikë dhe Financa është grup që e bën përcaktimin e rendit të ditës. Në KPF e as në Kuvend nuk është marrë qëndrim që informatat dhe raportet që nuk votohen mos të jenë në KPF. Ky është qëndrim i ekzekutivit, me kryesuesin dhe me sekretarinë e kuvendit. Nuk mund të thuash që kur është bërë plani i punës së kuvendit është paraparë mos të jenë, sepse në seancën e janarit, shkurtit dhe të marsit i kemi pasur të gjitha në KPF. Kjo praktikë ka filluar në maj.

**Skender Hamza:** Burim, nuk dëshiroj të replikojmë me njëri-tjetrin, por nuk ka pasur informata as në janar, as në shkurt, as në mars, as në prill, kanë qenë drejtpërdrejt në Kuvend. Thashë ka qenë si rekomandim, kemi diskutuar bashkë, jemi pajtuar dhe e kemi praktikuar. Thash mund të kesh të drejtë që raporti financiar është mirë të jetë, si dhe prej 9-mujorit do të jetë edhe në KPF. Drejtori te ne e ka dërguar me kohë, por ne si sekretari kemi vazhduar me rekomandim.

**Kryesuesi:** Burim, nuk ka pasur në asnjë mbledhje. Sa i përket asaj që the injorancë ndaj KPF-së, kjo nuk vije në shprehje. Nuk dyshoj tek e drejta jote, por as te përvoja e Skenderit. Në fund të fundit, të gjithë punojmë bashkë. Mendoj që përderisa nuk votohet, nuk e shoh të arsyeshme të diskutohet në KPF.

**Defrim Kafexhiu:** Faleminderit, kryesues! Ju përshëndes edhe një herë. Zakonisht ne iu drejtohemi qytetarëve dhe KPF-ja është organ i Kuvendit për shqyrtim të brendshëm të pikave dhe të propozimeve të ekzekutivit. Cili është qëllimi që ne i diskutojmë këtu, përpos ndonjë gabimi teknik, apo kërkesë shtesë që mund të jetë. Përndryshe, është mirë të jenë, por edhe mos të jenë, do t'i diskutojmë në Kuvend. Si të doni!

**Burim Krasniqi:** Për hir të opinionit, sepse këto mbeten në procesverbal. Skender, më datë 20.2.2024 është bërë vendimi 01 nr.02/2024, për KPF-në të datës 29 shkurt 2024, rendi i ditës, ndër të tjera është: Raporti nga Zyra e

Brendshme e Auditimit për 2023 (KPF-ja e muajit shkurt), raporti mbi zbatimin e rekomandimeve të ZKA-së 2022, që edhe kjo nuk votohet, informatë e DKA-së për përfundimit e gjysmëvjetorit të parë. Mos thuaj që nuk ka pasur për diçka që ka pasur dhe fatbardhësisht që i kemi në kompjuter dhe i shohim për dy minuta. Në janar, shkurt, mars, janë diskutuar në KPF edhe informatat të cilat nuk janë votuar. Ndryshimi ka filluar prej marsit, prillit. Kur flas diçka, e flas me goxha përgjegjësi.

**Kryesuesi:** Faleminderit, Burim Krasniqi! Vazhdojmë me dy pikat e prezantuara nga drejtori Afrim Oruqi dhe i vendosim në votim, kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Atëherë me 6 vota pro, asnjë kundër dhe asnjë abstenim votohen dy pikat shtesë.

**Nënkryetari:** E marrim për bazë gjithashtu edhe kërkesën e asambleistit Burim Krasniqi. Jemi të gatshëm, sepse lista ekziston dhe do ta kemi në Kuvend.

**Defrim Kafexhiu:** Meqenëse jeni të gatshëm, kërkoj që, jo vetëm emrat e shfrytëzuesëve, por edhe raportet e komisionëve. Në raport përfshihet çmimi, emri dhe afati i marrjes në shfrytëzim të pronës.

**Kryesuesi:** Atëherë, e vendosim në votim propozimin e Burim Krasniqit. Kush është “për”?... Atëherë, unanimisht votohet kjo pikë. E vendosim në votim rendin e ditës si të tillë. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me 6 vota pro, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, votohet rendi i ditës për sot.

#### **1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:**

**Kryesuesi:** A ka dikush ndonjë diskutim rreth procesverbalit? Nëse jo, atëherë e vendosim në votim! Kush është “për”?... Konstatohet që me shumicë votash (5 vota “për”) votohet pika e parë e rendit të ditës.

#### **2. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale Nr. 00889-0, ZK- Çifllak, në sipërfaqe prej 11765m<sup>2</sup>:**

**Afrim Oruqi:** Faleminderit, kryesues! Të nderuar anëtarë të KPF-së, bëhet fjalë për zonën kadastrale në Çifllak, parcela është e komunës P-00889-0. Po marrim vendim për ta dhënë me qira për 15 vjet, me qëllim bujqësor, në sipërfaqe prej 1 ha, 16 ari e 15m<sup>2</sup>.

**Kryesuesi:** Faleminderit, drejtor! A kemi ndonjë diskutim? Nëse jo, atëherë e vendosim në votim, kush është “për”?... Atëherë me 5 vota pro, asnjë kundër dhe asnjë abstenim votohet pika e dytë e rendit të ditës.

#### **3. Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës P-00889-0, ZK, Çifllak, në sipërfaqe prej 11765m<sup>2</sup>:**

**Afrim Oruqi:** Bëhet fjalë për vendim që të formohet komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, për të njëjtën parcelë dhe të njëjtën sipërfaqe. Komisioni do t'i ketë 5 anëtarë, 2 nga ekzekutivi, 2 nga kuvendi dhe 1 nga sektori joqeveritar.

**Kryesuesi:** Faleminderit, drejtor! A kemi ndonjë diskutim? Nëse jo, atëherë e vendosim në votim, kush është “për”?... Atëherë me shumicë votash, 6 vota pro, asnjë kundër dhe asnjë abstenim votohet pika e tretë e rendit të ditës.

#### **4. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale Nr. 00889-0, ZK- Çifllak, në sipërfaqe prej 10,000 m<sup>2</sup>:**

**Afrim Oruqi:** Bëhet fjalë në zonën e njëjtë në Çifllak, me numër të njëjtë të parcelës. Kërkoj nga sekretariati një përmirësim, bëhet fjalë për 86 ari dhe jo për 1 hektar. Qëllimi: kultivimi i pemëve dhe i perimeve.

**Kryesuesi:** Faleminderit, drejtor! A kemi ndonjë diskutim? Nëse jo, atëherë e vendosim në votim, kush është “për”?... Atëherë me 5 vota pro, asnjë kundër dhe asnjë abstenim votohet pika e katërt e rendit të ditës.

#### **5. Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, P-00889-0 ZK, Çifllak, në sipërfaqe prej 10,000 m<sup>2</sup>:**

**Afrim Oruqi:** Sipas ligjit, jemi duke marrë vendim të formojmë komision për t'i shqyrtuar ofertat për parcelën e njëjtë, me sipërfaqe të njëjtë dhe në zonën e njëjtë. Komisioni do t'i ketë 5 anëtarë, 2 nga ekzekutivi, 2 nga Kuvendi dhe 1 nga sektori joqeveritar.

**Kryesuesi:** Faleminderit, drejtor! A kemi ndonjë diskutim?... Atëherë e vendosim në votim, kush është “për”? Atëherë me shumicë votash, 5 vota pro, asnjë kundër dhe asnjë abstenim votohet pika e katërt e rendit të ditës.

#### **6. Shqyrtimi i propozim-vendimit për faljen e borxhit të papaguar për taksën komunale, respektivisht - qiranë e shfrytëzimit të hapësirës publike:**

**Përparim Krasniqi:** Faleminderit, kryesues! Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! E kemi një kërkesë prej Bajram Ramadanit nga Krusha e Madhe. Ka qenë një objekt i përkohshëm, tani aty është ndërtuar parku i ri dhe janë bërë objektet – kiosqet. Ai kërkon ta vazhdojë kontratën, mirëpo, prej vitit 2011-2017 nuk ka punuar fare, i kemi gjithashtu edhe procesverbalet nga inspektorati që nuk ka punuar. E kemi bërë një propozim-vendim që në këtë periudhë t'i falet borxhi. Ndërsa, për periudhën tjetër për të cilën Bajram Ramdani ka obligim për pagesë, t'i bëhet një marrëveshje, t'i afatizohet borxhi i akumuluar dhe të kryhet pagesa.

**Defrim Kafexhiu:** Realisht jam “për” nëse ai ka qenë jashtë funksionit të veprimtarisë. Kërkoj prej Drejtorisë së Inspektoratit që nëse ka procesverbale të përvitshme, apo kohë pas kohe ka punuar, apo nuk ka punuar për këtë periudhë hiç asnjë ditë?...

**Burim Krasniqi:** E para, ekziston një vendim për dhënien në shfrytëzim. Nëse ka vlerësim të inspektoratit që ai nuk ka operuar, atëherë nuk ka nevojë për të ardhur në Asamble. Komuna mund ta bëjë. Kjo nuk është falje e borxhit, është mosoperim në lokal. Në bazë të procesverbalit të inspektoratit që nuk ka punuar objekti, ta nxjerrë një vendim komuna që të pauzojë periudhën kohore të mosshfrytëzimit. Falja e borxhit në këtë rast është joparimore, sepse dikujt t'i falet e dikujt jo, është standard i keq. Është mirë ta nxjerrësh komplet listën e qiramarrësve dhe të gjithë ata që s'kanë paguar në këtë periudhë, t'u falet të gjithëve. Është shkelje e të drejtave të njeriut, që dikujt t'i falet e dikujt jo, gjithashtu është diskriminuese. Propozoj që, nëse nuk ka dëshmi të moskryerjes së veprimtarisë në atë pjesë, le të merren të gjithë ata që nuk kanë operuar dhe kanë objekte me qira, të thonë që të falet borxhi prej periudhës 1.1.2011 deri 31.12.2017, për të gjithë ata që kanë mbetur borxh. Është presedan i keq, sepse i stimulojmë që mos t'i kryejnë obligimet ndaj Komunës. Nuk është hera e parë që kemi rast të tillë, i kemi falur edhe disa borxhe të tjera dhe fatkeqësisht pa ndonjë analizë se pse janë akumuluar ato borxhe. A ka të drejtë Komuna ta bëjë këtë punë? Pse ta bëjë Asambleja? Nuk është falje e borxhit, por mosshfrytëzim i lokalit. Në qoftë se falet një borxh, le t'u falet të gjithëve. Unë personalisht e njoh Bujarin dhe Albanin. Të merret një vendim i përgjithshëm.

**Përparim Krasniqi:** Në fillim, thashë që ne kemi procesverbale për periudhën që nuk ka punuar. Gjithashtu e kemi listën se prej cilës periudhë ka obligime dhe prej cilës periudhë nuk ka punuar fare. Pavarësisht vendimit që do të merret në kuvend, do të ishte mirë të ndërrohet emri “borxh” dhe të zëvendësohet me një tjetër. Lokali ka qenë i pashfrytëzuar. Drejtorja nuk ka të drejtë të marrë vendim për falje ose për pezullim të borxhit, është rekomandim i auditorit. Për pjesën tjetër të obligimit që ka mbetur rreth 5800€, është menduar ta bëjmë një draft-marrëveshje që mos ta obligojmë palën t'i paguajë menjëherë.

**Leonard Morina:** Faleminderit, kryesues! Nëse ky operator e ka pasur në kontratë, e ka marrë në shfrytëzim dhe nuk ka operuar, nuk është faji ynë në këtë rast që ne ta lirojmë nga borxhi. Ne mund t'i uzurpojmë të gjitha pronat dhe mos të operojmë dhe në fund të themi “falma borxhin”. Nuk më duket e drejtë, nëse nuk i falim të gjithë. Nëse tani aty janë bërë kiosqe të reja, ai kërkon që përsëri ta marrë me qira? Kjo nuk është e logjikshme, një operator që nuk e ka paguar borxhin, tani kërkon t'i falet dhe që të jetë pretendent ta marrë me qira.

**Përparim Krasniqi:** Pala nuk kërkon që t'i falet borxhi. Ne po flasim për një periudhë që nuk ka punuar. Kemi procesverbal të inspektoratit që prej vitit 2011-2017 nuk ka punuar. Ndërsa, për periudhën tjetër që ka punuar, pala është e interesuar të paguajë dhe t'i vazhdohet kontrata e re. Ne si drejtori nuk kemi të drejtë t'ia vazhdojmë kontratën, pa hyrë në procedura të marrëveshjes. Vendimi varet nga ju.

**Kryesuesi:** Atëherë, nëse nuk kemi diçka tjetër, këtë pikë e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me 4 vota “për”, asnjë kundër dhe 1 abstenim, votohet pika e gjashtë.

#### **7. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik P-00041-1, ZK-Drenoc;**

**Afrim Oruqi:** Për shkak se njoftimi nga AKP-ja ka ardhur me vonesë dhe unë nuk kam material para vetes. Parimisht po ju njoftoj që pika e parë ka të bëjë me zonën kadastrale në Drenoc. Toka është më shumë se 1 hektar dhe është në menaxhimin e Agjencionit Pyjor të Kosovës. Gjendet në dalje të Drenocit, në anën e djathtë, aty ku para luftës ka qenë ndërtesa e njohur me emrin KB Bujku – Drenoc, ndërtesë administrative me sipërfaqe 200m<sup>2</sup>. Gjatë luftës dhe pas saj është shfrytëzuar si shtab i UÇK-së. Kërkojmë nga ju që ta shpallim me interes të përgjithshëm objektin.

#### **8. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik ndërtesën P-00644-0, ZK-Rahovec;**



**Afrim Oruqi:** Sa i përket pikës së dytë shtesë, ka të bëjë me zonën kadastrale në Rahovec. Janë dy lokale në të njëjtin objekt në qendër. Një lokal me sipërfaqe prej 70m<sup>2</sup> dhe një lokal tjetër në sipërfaqe 74.64m<sup>2</sup> që ka operuar Bankosi. Këtu dy lokale janë në këtë ndërtesë dhe ne po i shpallim me interes të përgjithshëm.

**Kryesuesi:** A kemi ndonjë diskutim në lidhje me dy pikat shtesë që i prezantoi drejtori? Nëse jo, atëherë i vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Me shumicë votash (5) votohen pikat shtesë.

#### 8. Të ndryshme:

**Defrim Kafexhiu:** Meqenëse edhe më herët u përmend plani i punës së Kuvendit, e lus kryesuesin bashkë me ekzekutivin që plani i punës së Kuvendit të zbatohet në përpikëri. Janë të përfshira edhe disa pika të tjera aty për muajin gusht.

**Burim Krasniqi:** Për kureshtje, që t’ia heq merakun Melindës, e nxora planin e punës së Kuvendit. Të gjitha pikat e rendit të ditës janë KPF-KK. Konsideroj që sekretaria ta rishikojë planin e punës, të votohet plotësimndryshimi dhe t’i hiqni ato pika që nuk do të jenë pjesë e diskutimeve në KPF. Të gjitha pikat janë KPF-KK. Për muajin korrik është i paraparë shqyrtimi i raportit të ZAP-së, besoj që është Zyra e Auditimit të Përgjithshëm. Kryesues, kur bëhet rendi i ditës është mirë që ta keni planin e punës para, edhe sekretaria.

**Skender Hamza:** Burim, Sekretaria e Kuvendit e kryen punën në përpikëri. E para, planin e punës së Kuvendit ne ia dërgojmë ekzekutivit. Nuk është detyrë e jona që t’i tregojmë ekzekutivit se çka duhet bërë. Ka qenë rekomandim nga grupi punues, që informatat dhe raportet mos të jenë pjesë e KPF-së. Për shkak të rëndësisë, kam propozuar që raportin e kryetarit ta kemi edhe në KPF.

**Burim Krasniqi:** Sekretaria mund të përgjigjet kur ne i kërkojmë përgjigje. Ata punojnë me ty dhe për ty. Nuk ka arsye që vazhdimisht të replikojë sekretaria, është praktikë jo e mirë. Ata janë për t’i shërbyer Kuvendit dhe jo t’i replikojnë Kuvendit. Kryesuesi është ai që i mbron dhe i arsyeton. E dyta, të gjitha pikat në plan të punës janë KPF-KK. Unë kërkoja që ky tabelor të rishqyrtohet prej sekretarisë dhe ato pika që nuk do të jenë në KPF, të hiqen dhe të mbetet veç KK. E përsëris, nuk është në rregull që sekretaria t’u replikojë asambleistëve.

**Nënkryetari:** Te asambleisti Defrim Kafexhiu, lidhur me planin e punës së Kuvendit, të muajit gusht, jemi në rregull. Në plan të punës mund të ketë lëvizje të pikave të rendit të ditës, përndryshe unë jam dakord me Burimin për këtë kërkesë, mirëpo është miratuar plani i punës dhe nuk është ndonjë “kijamet” i madh që edhe të hiqen pikat, por, veç të respektohet procedura që ata që e kanë bërë planin të takohen edhe një herë, të rishqyrtohet dhe të vendoset në kuvend dhe vazhdojmë tutje. Sa u përket keqkuptimeve me sekretarinë e kuvendit, Skenderi e bën një punë dhe është shumë normale që e mbron punën, siç unë që e bëj një punë dhe vazhdimisht e mbroj.

**Kryesuesi:** Burim, me profesion jam arkitekt, por nuk është që nuk jam në ngjarje me punën e kryesuesit. Udhëheqësi i Zyrës së Kuvendit është Skender Hamza dhe nëse një raport nuk sillet në KPF, patjetër që në kuvend do të diskutojmë 7 deri në 8 orë, një ditë ose dy ditë. Skenderi u tregua i drejtpërdrejtë. Nëse nuk keni edhe diçka tjetër, ju informoj që për mbledhje të rregullt të Kuvendit do të jetën edhe këto pika:

1. Shqyrtimi i Informatës së Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural;
2. Shqyrtimi i informatës së Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale;
3. Shqyrtimi i Raportit së Drejtorisë për Arsim rreth përfundimit të vitit mësimor 2023/2024;
4. Shqyrtimi i Informatës mbi realizimin e Planit të Punës së Zyrës së Prokurimit, janar-qershor 2024;
5. Shqyrtimi i Informatës mbi parcelat publike të dhëna në shfrytëzim nga Kuvendi Komunal;
6. Shqyrtimi i Informatës mbi realizimin e planit për mirëmbajtjen e hapësirave të hapura publike në Komunën e Rahovecit.

Ju falënderoj për vëmendjen, shihemi në mbledhjet e radhës!

Procesmbajtësi:

Albion Krasniqi

